

NE EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit Hasan Sadiku, me **proqesmbajsen Mimoza Mehmeti** në lëndën penale kundër të akuzuarve B.B. nga fsh.K. e vjetër Komuna e Novobërdës, për shkak të veprave penale ,importi ,eksporti ,furnizimi ,transportimi ,prodhimi ,këmbimi ,ndërmjetsimi ose shitja e pa autorizuar e armëve apo materjeve plasëse nga neni 372 paragrafi 1të KPRK-së dhe vjedhje r rëndë nga neni 253par.1 të ,KPRK-së dhe të akuzuarit R.G.nga fsh. K.KK.Graçanicë çër shkak të veprës penale ,importi ,eksporti , furnizimi ,transportimi ,këmbimi ,ndërmjetsimi ,ose shitja e pa autorizuar e materjeve plasëse nga n.372parag.1të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan,Departamenti për krime të rënda PP.II.nr.34/13, të datës 29.03.2013, të cilën e ka përfaqësuar prokurori i shtetit Shefik Mehmeti,pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar ,më dt.07.11.2016 ndërsa me datë 08.11.2016 mori dhe publikisht shpalli publikisht këtë,

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. Z., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati Y., dhe e ëma ,F,e lindur B. , i lindur më 25.01.1984, në P. ,ka të kryer shkollën fillore , i martuar , invalid i shkallës së parë gjendjes së varfyr ekonomike, shqipëtar, shtetas i Republikës së Kosovës, deri me tani i pa dënuar dhe nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale ndaj tij.

I kuzuari,R. G.i,pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati M., dhe e ëma Sh.,e lindur A. e lindur më, në fshatin M.,tani me vendbanim në fsh.,K.K.K. Komuna e Graçanicës . ,ka të kryer shkollën fillore i martuar ,baba i pesë fëmijve pensioner gjendje së varfër ekonomike deri më tani kinse i pa dënuar dhe nuk zhvillohet ndonji shqiptare shtetase e R. së Kosovës, deri me tani i pa dënuar dhe nuk zhvillohet ndonjë procedure tjetër penale ndaj tij.

Të akuzuarit B.Z. dhe E. H.

J a n ë f a j t o r

1.I akuzuari B.Z

Sepse më datë 29.12.2012 në shtëpinë e S.B.,në Novobërdë ,e ka vjedhur pushkën e gjuetisë të modelit Double Barrel me nr serik.....e cal... mm.,e cila arme me datë 30.12.2012 ia shet të akuzuarit R.G.në shumë prej 250euro.

-me çka ka kryet veprën penale ,furnizimi,transportimi ,prodhimi ,këmbimi ,ose shitja e pa autorizuar e armëve nga neni 327 pragrafi 1 nënparagrafi 1të KPK-së.

II

Sepse më datë 29.12.2012 në Novobërdë ,me qëllim të përfitimit të kundërligjsjëm pasuror , ka kryer vjedhjen në dëm të të dëmtuarës S. B.nga Novobërda me forcë, duke thyer dritren e pasme të shtëpisë ,hynë në shtëpinë e të dëmtuarës dhe e vjedhë një televizor dhe një pushkë të gjuetisë të modelit me nr serik.....T-.....e cal.....mm.

-me çka ka kryer veprën penale ,vjedhja e rëndë neni nga neni 253.para 1nënparag.1të KPK-së.

III

Sepse më datë 30.12.2012,pa autoriyim dhe leje valide ka bler; dhe mbajtur në pron;si arm;n e zarrt dhe ate nj; pushkëtë modelit me nr. SerikT në Novobërdë ,me qëllim të përfitimit të kundërligjsjëm pasuror , ka kryer vjedhjen në dëm të të dëmtuarës S. B.nga Novobërda me forcë, duke thyer dritren e pasme të shtëpisë ,hynë në shtëpinë e të dëmtuarës dhe e vjedhë një televizor dhe një pushkë të gjuetisë të modelit me nr serik.....T-.....e cal.....mm. Të cilën armë më parë e kishte blerë nga i akuzuari B. Z.për shumën prej 220euro ,ku pas hetimeve nga ana e policisë e njëjta armë gjendet dhe konfiskohet .

-me çka ka kryer veprën penale ,furnizimi transportimi prodhimi ,këmbimi ,ose shitje e pa autorizuar e armëve nga neni 327.para. 1të KPK-së.

andaj gjykata në bazë të nenit 3, 4, 41, 45,51,73,74, 75 dhe 76 të KPK-së, si dhe 391 të KPPRK-së, gjykata i përcakton.

Të akuzuarit:B. O.

Për veprën penale të cekur në pikën I të dispozitivit me dënim me kusht në kohëzgjatje prej 8(tetë) muaj.

Për veprën penale nën II,të dispozitivit me dënim me kusht në kohëzgjatje prej 1(një)viti.

Aaj konform dispozitës së nenit 80 të KPRK-sëpër këto dy vepra penale .

E G J Y K O N

Me dënim unik me dënim burgu në kohëzgjatje pre,1(nji)vit e 6(gjashtë)muaj e të cilin dënim nuk do ta mbajnë ,ne qofte se ne afat prej 2(dy)vite ,nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjzkimi nuk kryen ndonjë vepër panle në të kundërtën dënimi me kusht ka për të iu revokuar .

Të akuzuarin R.G.

Për veprën e cekur në pikën **III** të këtij dispozitivi me dënim burgunë kohë zgjatje prej 8(tetë)muaj ,të cilin dënim nuk do ta mbaj ,në qoftë se në afat prej 1 (një) nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonji vepër tjetër penale , në të kundërtën dënimi me jusht ka për të iu revokuar.

Të akuzuarit detyrohen që në emër të paushallit gjyqësor sejcili të paguajnë shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kërcënim përmbarimi të dhunshëm.

E dëmtuara S.B. për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzën, PP.II.nr.340/2013 , të datës 29.03.2013 i ka akuzuar B.B. nga fsh.Ll. ,Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale importi ,eksporti ,furnizimi ,transportimi ,prodhimi ,këmbimin ndërmjetsimi ose shitja e pa autorizuar materieve plasëse nga neni 372 paragra 1 të KPRK-së.dhe veprës penale vjedhke e randë nga neni 253parag.1nën parag,1 të KPRK-së,dhe R.G.nga fsh.K.,për shkak të veprës penale importi ,eksporti ,furnizimi ,transportimi ,prodhimi ,këmbimin ndërmjetsimi ose shitja e pa autorizuar materieve plasëse nga neni 372. paragra 1 të KPRK-së.

Prokurorja e e shtetit Huma Jetishi në seancën fillestare ka deklaruar : se mbetem në tërësi pranë aktakuzës së ushtruar me shkrim,dhe i propozoj që të akuzuarit të shpallën fajtor dhe të ju shqiptohet dënimi meritor sipas kodit penal ,gjithnji duke i marrë për bazë lehtësuese dhe ato rënduese .

I akuzuari B.B. ne shqyrtimin fillestar ka deklaruar se se :e pranoj e fajsinë për veprat penale si në aktakuzë ,sepse është e vërtet e gjith ajo që është e cekur ne aktakuzë , me vjen shumë keq për atë qfar ka ndodhur ,pendohem për kryerjen e këtyre veprave penale dhe i prmtoj gjykatës se në të ardhmen kurrë nuk di të biem ndesh me ligjin ,se këtë pranim të fajsisë e bëjë në mënyrë vullnetare dhe se jam i njoftuar për pasojat dhe benifitet e pranimit të fajsisë,andaq e lus gjykatën që të ma shqiptoi një dënim sa ma të butë

I akuzuari R. G.në shqyrtimin fillestar e pranoj fajsinë për veprën penale të cilën ma vë në barrë aktakuza ,më vjen keq për ate që ka ndodhur ,por i premtoj gjykatës se në te ardhmen kurr nuk do të bie ndesh me ligjin ,por i premtoj gjykatës se në të ardhmen kurr nuk do të bie ndesh me ligjin ,se këtë pranim e bëjë në mënyrë vullnetare pa kurrfarë presioni dhe shtrëngimi , edhe pse jam i njoftuar për të gjitha pasojat dhe benifitet e pranimit të fajsisë ,andaq i propozoj gjykatës që të ma shqiptoj ni dënim sa më të butë.

Meqenëse të akuzuarit në seancën fillestare të kësaj qështje e kan pranuar fajsinë për të gjitha pikat e aktakuzës e me këtë sipas vlerësimit të kësaj gjykate ,gjendja faktike në këtë qështje penale nuk është kontestuese ,sepse porpos pranimit të fajsisë nga ana e të akuzuarve për veprat e kryera ,një pranim i tillë ka edhe mbështetje në provat e grumbulluara të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se të akuzuarit vullnetarisht e kan pranuar fajsinë ,se i kan pranuar pasojat e pranimit dhe se aktakuza nuk përmban as një shkelje ligjore , apo ndonji gabim teknik ,andaj gjykata e vazhdoi procesin ndaj të njëjtit me shqiptimin e dënimeve pa shkuar fare në shqyrtimin gjyqësor , kështu duke vepruar në pajtim me dispozitën e nenit 248 parag.4të KPPK-së,dhe pa fjalën përfundimtare të palëve .

Duke u nisur nga fakti se vceprat penale të cekura në aktakuzë,janë kryer mer date 29.12.dhe 30.12.2012 qka do të thotë para hyrjes në fuqi të KPRK-ës,ndërsa të akuzuarit janë akuzuar me dispozitat e reja të KPRK-ës e të cilat kanë paraparë dënime më të ashpra ,andaj gjykata duke u mbështetur në dispozitat e nenit 3të të KPRJ-ës ,bëri rikualifikimin e veprave penale në bazë të dispozitave të ligjit më të favorshëm i cili ka qenë në fuqi në kohën e krzerjes së veprave penale .

Me rastine përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të akuzuari B.B dhe R:G., gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanndikim që dënimi të jetë më i butë apomë i rëndë ,ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së .Kështu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit B.B ,gjykata pati parasysh pranimin e fajsisë qka do të thotëse të akuzuarit kanë pranuar të jetë bashkëpunues ,është penduar për veprën penale ,si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të bien ndesh me ligjin se i njëjti është invalidi kategorisë së parë i gjendjes së varfër ekonomoke .Gjithashtu edhe çër të akuyuarin R.G.gjykata si rrethanë lehtësues mor faktin se i njëjti e ka prenuar fasinë është penduar për krzerjene kësaj vepre penale e po ashtu edhe kla premtuar se në të ardhmen nuk do të ndërmarrndonji veprim të kundërligjshëm ,se është baba i tre fëmijve të mitur i gjendjes së varfur ekonomike se deri me tani nuk ka rënë ndesh me ligjin se është pensionist.Ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarit gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjësisë panale ,si dhe rrezikshmërinë shoqërore .

Andaj gjykata është e bindur se dënimet e shqiptuara për të akuzuarit,janë në harmoni të plotë me përgjegjësit e tyre penale dhe peshën e veprave penale ,dhe se me dënimet e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të akuzuarit do ti parandaloj ë që në të ardhmen të mos kryejnë vepra tjera penale dhe do të ndikoj ë tek qytetarët tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale .

Vendimin mbi realizimin e kërkesës pasurore juridike Gjykata ,e bazoi në dispozitën e nenit 463parag.të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN ,Dega në Novobërdë

-Departamenti i pergjithshem

P.nr.32/2016, më 08.11.2016.

Hasan Sadiku

Procesmbajtsja

G j y q t a r i

Mimoza Mehmeti

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, në afat
Prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykim.

Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë,
përmes kësaj gjykatë.